
2XX BLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA

LISTA E FUSHAVE

- 200 Pikëqasja e njësuar – emër vetjak
- 210 Pikëqasja e njësuar – emër organizate
- 215 Pikëqasja e njësuar – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik
- 220 Pikëqasja e njësuar – emër familje
- 230 Pikëqasja e njësuar – titull
- 240 Pikëqasja e njësuar – emër/titull
- 243 Pikëqasja e njësuar – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare
- 250 Pikëqasja e njësuar – emër i përgjithshëm
- 280 Pikëqasja e njësuar – forma, zhanri ose karakteristikat fizike

Bloku përmban pikëqasjen, për të cilën është krijuar regjistrimi. Në regjistrimin e njësuar kjo është pikëqasja, në regjistrimin referues është varianti i pikëqasjes, ndërsa në regjistrimin e përgjithshëm shpjegues është pikëqasja shpjeguese.

Çdo regjistrim duhet të përmbaj një fushë nga blloku 2XX. Fushat nga blloku 2XX mund të përsëriten vetëm në sistemet COBISS që kanë nevojë për pikëqasjet në disa shkrime.

Në fushat 2XX përdoret ky kontroll i nënfushave:

7	<i>Shkrimi i pjesës kryesore të pikëqasjes</i>
9	<i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>

Përdorimi i nënfushave të kontrollit është përshkruar në kapitullin *Nënfushat e kontrollit* (para bllokut 2XX).